



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 181

Tiranë – E mërkurë, 28 shtator 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 19/2016 datë 22.9.2016	Për masat shtesë të sigurisë publike..... 20781
Vendim i Kuvendit nr. 63/2016, datë 22.9.2016	Për miratimin e dekretit nr. 9501, datë 4.4.2016, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike””..... 20785
Vendim i Kuvendit nr. 64/2016, datë 22.9.2016	Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi..... 20785
Vendim i Kuvendit nr. 65/2016, datë 22.9.2016	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 47/2013 “Për caktimin e përbërjes së sekretariateve të Kuvendit”, të ndryshuar..... 20786
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 21.9.2016	Për disa shtesa në vendimin nr. 207, datë 16.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për llogari të vet dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme”..... 20786
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 21.9.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 954, datë 25.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit”, të ndryshuar..... 20787
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 661, datë 21.9.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 915, datë 11.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve të bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”..... 20787
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 21.9.2016	Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta..... 20794

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 663, datë 21.9.2016	Për ndryshimin, me shkëmbim notash, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit “Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave”.....	20797
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 664, datë 21.9.2016	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Ilir Ohri.....	20797
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 665, datë 21.9.2016	Për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme.....	20798
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 6406, datë 27.9.2016	Për delegim kompetence.....	20836
	Korrigjim gabimi material.....	20836



LIGJ
Nr. 19/2016

PËR MASAT SHITESË TË SIGURISË
PUBLIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve ligjore për sigurimin e bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe subjekteve publike e private, veprimtaria e të cilave përbën burim rreziku të shtuar për sigurinë, me synim zbulimin, parandalimin dhe goditjen e çdo veprimtarie kriminale, në mbrojtje të pronës, jetës dhe garantimin e sigurisë publike.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji është:

- a) përcaktimi i kategorive të subjekteve që zhvillojnë veprimtari, të cilat, për shkak të rrethanave dhe kushteve specifike, përbëjnë burim rreziku të shtuar për sigurinë;
- b) përcaktimi i faktorëve për vlerësimin e rrezikut;
- c) përcaktimi i masave shtesë të sigurisë;
- ç) njoftimi i subjekteve për vendosjen e masave shtesë të sigurisë, pas vlerësimit të bërë nga Policia e Shtetit;
- d) përcaktimi i procedurës për dhënien, heqjen dhe ripajisjen me “Vërtetim sigurie”.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrator i ndërtesës së banimit” është personi fizik i përfshirë në librin e

administratorëve të bashkisë për të ushtruar veprimtari në fushën e administrimit të ndërtesave të banimit.

3. “Mallra të rrezikshme” janë substanca ose artikuj, përdorimi apo shpërndarja e paautorizuar e të cilave shkakton dëmtime në persona apo në mjedis, si rezultat i veprimit radioaktiv, shpërthyes, helmues apo djegës.

3. “Mjete transporti” janë mjetet që ofrojnë shërbime në transportin rrugor të udhëtarëve, të nxënësve, të studentëve, të vlerave monetare dhe të mallrave të rrezikshme.

4. “Mjedis i hapur” është mjedisi i pakufizuar, në të cilin qëndrojnë ose lëvizin në të njëjtën kohë një numër i konsiderueshëm personash ose automjeteve, të tilla si: sheshe publike, parqe, kënde lojërash, mjedise parkimi të automjeteve etj.

5. “Mjedis i mbyllur” është objekti i kufizuar në sipërfaqe dhe i ndarë nga mjediset e tjera, në të cilin mund të zhvillohen veprimtari të ndryshme ekonomike, tregtare, sportive, kulturore, mjedise publike e private për shërbime, parkim automjeteve, mbajtje të depozitave të ujit etj.

6. “Njësi shërbimi” janë ndërtesat, mjediset, lokalet, ku zhvillohen veprimtari ekonomike, tregtare, kulturore, sportive, argëtimi dhe çdo njësi, shërbimi i së cilës përfshin frekuentimin e qytetarëve, vlerave monetare dhe mallrave.

7. “Njësi të lojërave të fatit” janë mjedise, në të cilat zhvillohen veprimtari, si: bastet sportive, bingo, lotaritë, kazinotë, kazinotë elektronike.

8. “Rrezik i shtuar për sigurinë” është ekzistenca e kushteve favorizuese për veprimtari të mundshme kriminale që përbëjnë kërcënim dhe rrezik të shtuar për jetën, pronën ose që cenojnë rendin e sigurinë publike.

9. “Subjekt publik” është institucioni shtetëror, enti publik, personi juridik publik, ndërmarrja shtetërore, bashkia.

10. “Subjekt privat” është personi fizik ose juridik, shtetasi shqiptar apo shtetasi i huaj.

11. “Të dhëna personale” kanë të njëjtin kuptim, sipas përkufizimit të bërë në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

12. “Vërtetim sigurie” është akti administrativ që lëshon Policia e Shtetit dhe që vërteton plotësimin e masave shtesë të sigurisë të marra nga subjektet.



KREU II
SUBJEKTET, MASAT SHITESË TË
SIGURISË, FAKTORËT DHE PROCEDURA
PËR PAJISJEN ME “VËRTETIM
SIGURIE” DHE ME SISTEME SIGURIE

Neni 4

**Subjektet private që detyrohen të marrin
masa shtesë sigurie**

Kategoritë e subjekteve, që detyrohen të marrin masa shtesë sigurie pas vlerësimit të analizës së rrezikut të bërë nga Policia e Shtetit janë:

a) subjektet që kanë selinë e mjediset e punës dhe ushtrojnë aktivitetin tregtar në vende të ekspozuara ndaj rrezikut të shtuar për sigurinë;

b) subjektet që kanë mbi 50 punonjës dhe/ose frekuentues, të cilët, në mënyrë të vazhdueshme, akomodohen apo frekuentojnë në të njëjtën kohë një mjedis të hapur ose të mbyllur;

c) subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar nga ora 23:00 – 06:00;

ç) subjektet që kanë aktivitet ekonomik, xhiroja vjetore e së cilës është mbi 10 milionë lekë;

d) subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e lojërave të fatit;

dh) subjektet që administrojnë mjedise të hapura apo të mbyllura për fëmijë, si: shkolla, kënde lojërash dhe që vlerësohen nga Policia e Shtetit si burim rreziku i shtuar;

e) subjektet që kryejnë veprimtari të transportit publik për udhëtarët, nxënësit, studentët, si dhe transport të vlerave monetare dhe të mallrave të rrezikshme.

Neni 5

**Detyrimi i subjekteve publike për marrjen
e masave shtesë të sigurisë**

1. Subjektet publike marrin masa shtesë sigurie në sheshe të hapura, parqe, kënde të lojërave, parkime, në mjedise të hapura apo të mbyllura, që kanë në administrim apo pronësi dhe që, sipas vlerësimit të Policisë së Shtetit, përbëjnë burim rreziku të shtuar për rendin dhe sigurinë publike.

2. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 6 muajve nga hyrja
Faqe | 20782

në fuqi e këtij ligji, përcaktojnë me udhëzim të përbashkët ngritjen dhe funksionimin e një regjistri, si bazë të dhënash qendrore apo vendore, në të cilin regjistrohen subjektet që, sipas këtij ligji, marrin masa shtesë të sigurisë publike.

3. Policia e Shtetit identifikon të gjitha subjektet që disponojnë dhe administrojnë sisteme të sigurisë, si kamera për regjistrim të pamjeve filmike, CCTV me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NRV/Server deri në 2 muaj apo përdorin pajisje elektronike të teknologjisë së lartë për identifikimin, në funksion të sigurisë (detektorë, ura kontrolli, *reader*, GPS etj.), me qëllim njoftimin dhe regjistrimin e tyre në regjistrin e të dhënave, të ngritur sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 6

**Masat shtesë të sigurisë në ambientet e
përbashkëta të banimit**

1. Administratorët e ndërtesave të banimit, me marrjen e vendimit të miratimit nga asambleja e bashkëpronarëve, sipas legjislacionit në fuqi, marrin masa shtesë sigurie sipas këtij ligji.

2. Rregullat për bashkëpunimin midis administratorëve të ndërtesave të banimit, njërive të vetëqeverisjes vendore dhe Policisë së Shtetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Faktorët për vlerësimin e rrezikut

Policia e Shtetit bën analizën e vlerësimit të rrezikut, duke u bazuar në faktorët e mëposhtëm:

a) veprimtarinë e subjektit, e cila ka qenë objekt i sulmeve të vazhdueshme kriminale, që kanë cenuar sigurinë e subjektit në 5 vitet e fundit;

b) ekspozimin e mjediseve e të aktivitetit të subjektit ndaj elementëve kriminalë;

c) llojin e veprimtarisë që kryhet;

ç) distancën e objektit ku ushtrohet veprimtaria nga njësia policore apo qendrat e banuara.

Neni 8

Masat shtesë të sigurisë

1. Masat shtesë të sigurisë janë:

a) përdorimi i sistemit të kamerave CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe, që



ruajnë imazhet filmike në NRV/Server deri në 2 muaj;

b) përdorimi i pajisjeve elektronike të teknologjisë së lartë për identifikimin, në funksion të sigurisë (detektorë, ura kontrolli, *reader*, GPS etj.);

c) në varësi të vlerësimit të rrezikut dhe në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, lidhja e sinjalit të alarmit për bankat dhe objekte të rëndësishme shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, me sallat e komandimit/informacionit të Policisë së Shtetit;

ç) përdorimi i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike (SHPSF).

2. Niveli i masave shtesë të sigurisë dhe lloji i masës që duhet të përdorin subjektet, sipas pikës 1, të këtij neni, në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

3. Vendosja dhe përdorimi i masave shtesë të sigurisë shoqërohet me njoftimin për publikun.

Neni 9

Autoriteti përgjegjës për pajisjen me “Vërtetim sigurie”

1. Autoriteti përgjegjës për pajisjen me “Vërtetim sigurie” është drejtori vendor i Policisë së Shtetit, ku zhvillon aktivitetin subjekti.

2. Autoriteti përgjegjës për pajisjen me “Vërtetim sigurie” të subjektit që ushtron veprimtari apo ka filiale në territorin e më shumë se një qarku është drejtori vendor i Policisë së Shtetit ku ka selinë qendrore subjekti.

3. Autoriteti përgjegjës e pajis subjektin me “Vërtetim sigurie” kur ai plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 4, të këtij ligji, si dhe kushtet e përcaktuara po në këtë ligj.

Neni 10

Njoftimi i subjekteve nga Policia

1. Subjektet, veprimtaria e të cilave rezulton si burim rreziku i shtuar, pas vlerësimit të bërë nga struktura vendore e Policisë së Shtetit, njoftohen zyrtarisht nga drejtoria vendore e Policisë për gjendjen e rrezikut dhe nivelin e masave shtesë të sigurisë që duhet të marrin, brenda 5 ditëve nga kryerja e vlerësimit.

2. Procedura e njoftimit të subjekteve për vlerësimin dhe gjendjen e rrezikut përcaktohet

me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 11

Procedura për pajisjen me “Vërtetim sigurie”

1. Subjekti merr masat e sigurisë, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit zyrtar.

2. Policia kontrollon, brenda 15 ditëve nga marrja e masave nga ana e subjektit, nëse janë plotësuar masat e përcaktuara dhe, brenda 15 ditëve nga kryerja e kontrollit, lëshon “Vërtetim sigurie”.

3. Të gjitha veprimet e parashikuara në këtë nen bëhen pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Pajisja me “Vërtetim sigurie” për banesat bëhet pas regjistrimit të administratorëve të pallateve në librin e administratorëve të bashkisë.

5. Forma dhe përmbajtja e “Vërtetimit të sigurisë” miratohen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

Neni 12

Procedura për pajisjen me sisteme sigurie

1. Vendosja dhe mirëmbajtja e sistemit të kamerave e të pajisjeve të teknologjisë së lartë bëhen nga subjekte që janë të regjistruara në Regjistrin Kombëtar Tregtar dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2. Në rast defekti të sistemeve të sigurisë, subjekti është i detyruar të bëjë riparimin e menjëhershëm, por jo më shumë se 15 ditë nga defekti.

3. Subjektet, të cilat instalojnë sistemin e kamerave apo pajisje elektronike të teknologjisë së lartë, detyrohen në çdo rast të njoftojnë dhe bëjnë transparente para Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, procedurat e kryerjes së çdo veprimi tërësisht ose pjesërisht automatik të përpunimit dhe transmetimit të të dhënave personale, të marra në zbatim të këtij ligji.

4. Niveli i sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë përcaktohet me udhëzim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



KREU III DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 13

Detyrimi për dhënie informacioni

Subjektet e këtij ligji vënë në dispozicion materialet vizive apo të dhënat e tjera, që përfitohen nga përdorimi i masave shtesë të sigurisë, me kërkesë të Policisë së Shtetit ose organeve të drejtësisë, vetëm për nevoja hetimi, bazuar në Kodin e Procedurës Penale dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 14

Përpunimi i të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale të përfituara nga sistemet e sigurisë, të parashikuara në këtë ligj, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Rastet e administrimit, përpunimit dhe të transmetimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 15

Inspektimi

1. Policia e Shtetit kryen inspektime periodike për monitorimin e përmbushjes së masave shtesë të sigurisë, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Rregullat për kryerjen e inspektimeve për monitorimin e përmbushjes së masave shtesë të sigurisë nga Policia e Shtetit, sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 16

Sanksionet dhe e drejta e ankimit

1. Mosmarrja e masave shtesë të sigurisë, të parashikuara në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji, nga subjektet e këtij ligji, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë si më poshtë:

a) mosmarrja e masës së parashikuar në shkronjën “a”, nga 5 mijë deri në 20 mijë lekë;

b) mosmarrja e masës së parashikuar në shkronjën “b”, nga 20 mijë deri në 50 mijë lekë;

c) mosmarrja e masës së parashikuar në shkronjën “c”, nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë;

ç) mosmarrja e masës së parashikuar në shkronjën “ç”, nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë.

2. Gjoha vendoset nga Policia nëse subjekti nuk ka marrë masat shtesë të sigurisë, pas kalimit të afatit prej 30 ditëve nga data e njoftimit për marrjen tyre.

3. Në rast se subjekti, pas 60 ditëve nga vendosja e gjobës, nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë ligj, Policia njofton zyrtarisht autoritetin përgjegjës për mungesën e masave shtesë të sigurisë publike.

4. Nëse pas inspektimit të kryer nga Policia e Shtetit ndaj subjektit të pajisur me “Vërtetim sigurie”, rezulton që janë shkelur detyrimet e përcaktuara në këtë ligj, për marrjen e masave shtesë të sigurisë, subjektit i hiqet “Vërtetimi i sigurisë”.

5. Kundër vendimeve për sanksionet e parashikuara në pikat 1 dhe 4, të këtij neni, bëhet ankim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit, sipas dispozitave të ligjit për kundërvajtjet administrative, në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, i cili ngrihet në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

6. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave bën shqyrtimin e ankimit brenda 30 ditëve nga depozitimi i tij.

7. Përbërja, kompetencat dhe procedurat e funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

8. Kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

Neni 17

Heqja e “Vërtetimit të sigurisë”

“Vërtetimi i sigurisë” hiqet në këto raste:

a) kur nuk plotësohen masat shtesë të sigurisë, të përcaktuara në këtë ligj;

b) me kërkesën e vetë subjektit, kur ndryshon objekti i aktivitetit dhe objekti i ri nuk sjell detyrime, sipas këtij ligji, ose kur subjekti mbyll aktivitetin;



c) kur subjekti gjobitet dy herë brenda 1 viti kalendarik.

Neni 18

**E drejta për t'u ripajisur me
“Vërtetim sigurie”**

Subjektit, të cilit i është hequr “Vërtetimi i sigurisë”, i lind e drejta të aplikojë për t'u ripajisur me “Vërtetim sigurie”, pas plotësimit të masave shtesë të sigurisë, të përcaktuara në këtë ligj.

**KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT DHE
KALIMTARE**

Neni 19

**Afati për marrjen e masave shtesë të
sigurisë**

1. Subjektet e përcaktuara në këtë ligj vendosin masat shtesë të sigurisë, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe brenda këtij afati aplikojnë për t'u pajisur me “Vërtetim sigurie”.

2. Sanksionet e parashikuara në nenin 16 zbatohen me kalimin e 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 20

Miratimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë vendim në zbatim të pikës 2, të nenit 6, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzim, në zbatim të pikës 2, të nenit 8, të pikës 2, të nenit 10, të pikës 2, të nenit 15 dhe të pikës 7, të nenit 16, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzim në zbatim të pikës 4, të nenit 12, të këtij ligji.

4. Ngarkohet Drejtori i Policisë së Shtetit që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë urdhër në zbatim të pikës 5, të nenit 11, të këtij ligji.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI

Edmond Spaho

Miraturar në datën 22.9.2016

**VENDIM
Nr. 63/2016**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT NR. 9501,
DATË 4.4.2016, TË PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E
LIGJIT NR. 19/2016 “PËR MASAT
SHITESË TË SIGURISË PUBLIKE””**

Në mbështetje të nenit 85 të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit nr. 9501, datë 4.4.2016, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike””.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI

Edmond Spaho

Miraturar në datën 22.9.2016

**VENDIM
Nr. 64/2016**

**PËR PROCEDURËN PARAPRAKE TË
PËRZGJEDHJES SË KOMISIONERIT
PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

Në mbështetje të neneve 23, 25 e 29 të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në zbatim të neneve 19, pika 1, e 34 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet procedura paraprake e përzgjedhjes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas fazave të mëposhtme:

a) Nga shërbimet e Kuvendit të bëhet shpallja dhe bërja publike e vakancës së organit të krijuar me ligj nga Kuvendi (në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik), për një afat prej 30 ditësh nga publikimi i këtij vendimi. Në shpallje përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet të shoqërojë CV-në e kandidatit për përmbushjen e kriterëve ligjore, si dhe pëlqimi i kandidatit me shkrim.

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, lista me kandidaturat e vetofruara u bëhet e njohur anëtarëve të Kuvendit.

c) Shërbimet e Kuvendit, brenda 5 ditëve nga dërgimi i njoftimit të deputetët i listës së kandidaturave të vetofruara, organizojnë dëgjuesën publike në mjediset e Kuvendit. Shërbimet e Kuvendit njoftojnë të gjithë deputetët/grupet parlamentare për ditën, orën dhe mjediset ku do të kryhet dëgjesa publike dhe prezantimet e çdo kandidati në këtë proces të hapur.

ç) Pas dëgjësës publike, të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin/kandidatët, bazuar në cilësitë profesionale dhe performancën gjatë prezantimit.

d) Kandidaturat që do të marrin mbështetjen e jo më pak se 28 deputetëve depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit.

II. Procedura paraprake, e propozuar në pikën I të këtij vendimi, nuk është e detyrueshme për t'u ndjekur nga deputetët, si dhe nuk përjashton në asnjë rast, që të paktën 28 deputetë t'i paraqesin Kuvendit një kandidat që është përzgjedhur prej tyre jashtë procedurës së sipërcituar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Edmond Spaho

Miratuar në datën 22.9.2016

VENDIM
Nr. 65/2016**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 47/2013 “PËR
CAKTIMIN E PËRBËRJES SË
SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 47/2013, “Për caktimin e përbërjes së sekretariateve të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Florion Mima (PD) caktohet sekretar i Sekretariatit për Buxhetin.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Edmond Spaho

Miratuar në datën 22.9.2016

VENDIM
Nr. 656, datë 21.9.2016**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.
207, DATË 16.3.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NGARKIMIN E
OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE SHA)
SI ORGAN QENDROR BLERËS, PËR
KRYERJEN E PROCEDURËS SË
PROKURIMIT PUBLIK PËR LLOGARI TË
VET DHE TË MINISTRISË SË PUNËVE
TË BRENDASHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për



menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3, të vendimit nr. 207, datë 16.3.2016, të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 3.1 dhe 3.2, me këtë përmbajtje:

“3.1. Ministria e Punëve të Brendshme, pas njoftimit të OSHEE sh.a., për nënshkrimin e kontratës, bën transferimin e fondit në vlerën 400 000 000 (katërqind milionë) lekë, përkatësisht 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga zëri “Investime” dhe 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga zëri “Mallra dhe shërbime”, parashikuar në programin e Gjendjes Civile për projektin “Ndërtimi i një sistemi funksional adresash”, tek OSHEE sh.a.

3.2. Për shërbimet, për të cilat përfituese është Ministria e Punëve të Brendshme (DPGJC), OSHEE sh.a., kryen pagesën pas konfirmimit të marrjes në dorëzim të këtyre shërbimeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 660, datë 21.9.2016

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 954, DATË 25.11.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE DHE TË FORMULARIT
TË LEJES SË LEGALIZIMIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 28, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 954, datë 25.11.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/1. Leja e legalizimit miratohet pasi të jetë administruar dokumentacioni i vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, vetëm nëse kjo taksë është llogaritur nga ALUIZNI dhe është arkëtuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 50/2014. Për rastet e tjera, ky dokumentacion administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, dhe mungesa e tij nuk pengon miratimin e lejes së legalizimit.

2/2. Dokumentacioni i pronësisë së parcelës ndërtimore ose i ndërtimit ekzistues, për shtesat pa leje, administrohet përpara miratimit të lejes së legalizimit vetëm nëse subjekti e disponon atë, sipas përcaktimeve të neneve 27, shkronja “d”, dhe 28, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Mungesa e këtij dokumentacioni nuk pengon miratimin e lejes së legalizimit.

I njëjti rregull vlen edhe për dokumentacionin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 27, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar.”.

2. Shkronja “a”, në pikën 9, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 661, datë 21.9.2016

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 915, DATË 11.11.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA
KËSHILLAT E QARQEVE TË BASHKITË,
TË RRJETIT TË RRUGËVE RURALE
DHE TË ASETVE TË LUAJTSHME E TË
PALUAJTSHME TË NDËRMARRJEVE TË
MIRËMBAJTJES SË KËTYRE RRUGËVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe të neneve 3, shkronja “P”, e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për



transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit të njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rrjetit të rrugëve rurale, i cili është kaluar nga këshillat e qarqeve në administrimin e bashkive, në bazë të vendimit nr. 915, datë 11.11.2015, të Këshillit të Ministrave, pas rakordimit t’i shtohen disa segmente rrugore, sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ndryshimin e inventarit të rrugëve të transferuara në Bashkinë Librazhd dhe Bashkinë Përrenjas sipas tabelës 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Transferimi të kryhet nën mbikëqyrjen e prefektit të qarkut.

4. Ngarkohen bashkitë për të kryer evidentimin e inventarit të rrugëve rurale e komunale dhe, në

bashkëpunim me Institutin e Transportit, të përditësojnë këtë rrjet rrugor në hartën digjitale duke iu referuar hartave bashkëlidhur këtij vendimi, brenda datës 31 dhjetor 2016. Harta digjitale e përditësuar publikohet në Gjeoportalin Kombëtar që administrohet nga ASIG-u.

5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme, Instituti i Transportit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale, prefektët e qarqeve, ASIG-u dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Tabela 1

Nr.	Emërtimi i aksit rrugor	Kilometra (km)
	Bashkia Berat	15
1	Kthesa Velabisht – Starovë – Vetterrik	9
2	Kthesa Lapardha – Lapardha 2	6
	Bashkia Ura Vajgurore	1.5
1	Rruga Ura Vajgurore – Vetterrik	1.5
	Bashkia Kuçovë	6
1	Lapardha 2 – Lumas	6
		22.5
	Bashkia Elbasan	54
1	K/Labinot Fushë - Bizë	54
		54

Tabela 2


Nr.	Emërtimi i aksit rrugor	Kilometra (km)
	Bashkia Përrenjas	112,5
1.	Rr. nacionale – Bushtricë	3
2.	Rr. nacionale – Qukës, Skënderbej	3
3.	Rr. nacionale /K. Pishkash–P. Veri/ Skroske	10
4.	Rr. nacionale/K. Pishkash–Min. Pishkash/ Lyqinje	7.5
5.	K/Qukës–Ura e Manastrecit/K. Katjel	21
6.	Ura e Manastrecit–Ura e Hakes	16
7.	Ura e Hakes–Qafë-Mali	10
8.	Rr. nacionale–Sutaj/Bardhaj	17
9.	Rr. nac./Pocivell–Kotodesh	4
10.	Golik–Homezh	21


Nr.	Emërtimi i aksit rrugor	Kilometra (km)
	Bashkia Librazhd	119
1.	Rr. nac./Ura Mirake–Gureshpat–Vilan	25
2.	Rr. nacionale–Dragostunje	7
3.	Rr. nac./Librazhd–Babje/Dardhë	17
4.	K/Qarrishte–Qarrishte	28




5.	Rrapun–Kuturman	5
6.	Rr. nac./Hotolisht–Kokreve Verri/ Kokr. Katund	4
7.	K/Borove–Borove	4
8.	K/Zabzun–Zabzun	4
9.	K/Lunik–Lunik Fshat	4
10.	Qafë-Drize–Zdrajsh–Orenje	21











**VENDIM****Nr. 662, datë 21.9.2016****PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
PËRDORIMIT TË UJIT DHE TË
SHKARKIMEVE TË LËNGËTA¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 48, pika 3, 82, pikat 1 e 2, e 92, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Tarifat e përdorimit të ujit, të parashikuara në tabelën nr. 1, bashkëlidhur vendimit, janë 0, kur në kontratën e koncesionit për hidrocentrale, të lidhur nga autoriteti përkatës kontraktor, është parashikuar pagimi i tarifës së koncesionit nga ana e koncesionarit.

3. Tarifat për përdorimin e ujërave ndërkufitare me leje, autorizim apo koncesion janë të njëjta me ato të përcaktuara sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Detyrimet financiare, sipas tarifave të tabelës nr. 1, derdhen çdo tre muaj në llogarinë bankare të degës përkatëse të thesarit të Ministrisë së Financave në emër të ministrisë përgjegjëse për ujërat. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e përcaktuara në këtë vendim derdhen në buxhetin e shtetit. Një kopje e mandatpagesës dorëzohet pranë Agjencisë së Basenit Ujor, ku ndodhet burimi ujor.

5. Vendimi nr. 23, datë 9.1.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Financave dhe agjencitë e baseneve ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

* Vendimi “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta” është në përputhshmëri të pjesshme me direktivën 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 23 tetor 2000, “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave, e amenduar nga direktiva e Komisionit 2014/101/EU e 30 tetorit 2014 dhe direktiva 2008/32/EC e PE dhe e Këshillit, datë 11 mars 2008 (OJ L 327, 22.12.2000, p. 1–73).



Tabela nr. 1

TARIFAT E PËRDORIMIT TË UJIT DHE TË SHKARKIMEVE TË LËNGËTA

	QËLLIMI I PËRDORIMIT TË UJIT	PËRDORUESIT	TARIFAT E SHKARKIMEVE TË LËNGËTA NË UJË	TARIFAT E PËRDORIMIT	
				Ujë sipërfaqësor	Ujë nëntokësor
1.0 FURNIZIMI ME UJË					
1.1		Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, prodhim uji deri në 10 milionë m³/vit	-----	0,05 (lekë/m³)	0,08 (lekë/m³)
1.2		Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, prodhim uji deri në 20 milionë m³/vit	-----	0,05 (lekë/m³)	0.09 (lekë/m³)
1.3		Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, prodhim uji mbi 20 milionë m³/vit	-----	0,05 (lekë/m³)	0.1 (lekë/m³)
1.4		Familje që nuk lidhen me rrjetin e furnizimit me ujë të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve më të afërta ose që duan të vetëfurnizohen	-----	-----	1.5 (lekë/m³)
1.5		Njësi tregtare e industriale, si: lavazhe, përpunim mermeri etj. kur ato shfrytëzojnë drejtpërdrejt ujëra sipërfaqësore ose një burim ujor nëntokësor	4 (lekë/m³)	1.5 (lekë/m³)	4.5 (lekë/m³)
1.6		Njësi tregtare të prodhimit të ujit mineral dhe natyral të ambalazhuar, destinuar për pirje	-----	5 (lekë/m³)	12.3 (lekë/m³)
1.7		Njësi tregtare e industrisë së prodhimit të pijeve alkoolike dhe joalkoolike me pus individual ose furnizim nga burimi	2.8 (lekë/m³)	5 (lek/m³)	12.3 (lekë/m³)
1.8		Ndërmarrje tregtare e industriale që përdorin ujin për proces tekniko-teknologjik për përpunimin dhe qarkullimin e naftës dhe derivateve të naftës, për ftohjen e gazit natyror,	5 (lekë/m³)	1.5 (lekë/m³)	2.5 (lekë/m³)



		metalurgjisë së zezë, metalurgjisë së ngjyrosur, industrisë minerare, industrisë së tekstilit, industrisë së letrës, lëkurës, fermave, thertoreve dhe industrisë së mishit, serviseve të automjeteve dhe makinave			
2.0 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE					
2.1		KESH		1% të çmimit të shitur për çdo kilovat në orë të prodhuar në hidrocentral	-----
2.2		Shoqëri private të prodhimit të energjisë, hidrocentrale	-----	2.3% të çmimit të shitur	-----
2.3		Termoelektrocentral me ftohje me sistem të hapur.	-----	1.7% të çdo kilovat- orë të prodhuar në termocentralet me sistem të hapur të ftohjes	-----
3.0	PËR UJITJE NË BUJQËSI DHE BLEGTORI				
3.1	Bujqësi	Ujitjen e tokave bujqësore nga liqene/rezervuar artificialë	2,5 (lekë/m ³)	500 (lekë/ha)	-----
3.2	Bujqësi	Ujitje nga burime natyrore	2.5(leë/m ³)	300 (lekë/ha)	-----
3.3	Blegtoria	Ujë për qëllime blegtorale	4 (lekë/m ³)	3 (lekë/m ³)	(4 lekë/m ³)
4.0	PËR AKUAKULTURË				
4.1	Impiante kultivimi intensive peshku etj.		1.2 (lekë/kg peshk i shitur)	1 (lekë/kg peshk i shitur)	2 (lekë/kg peshk i shitur)
5.0	UJËRA KURATIVE, TERMOMINERALE, MINERALE DHE GJEOTERMALE	Shoqëri private (llixhat)	4.5 (lekë/vaskë/muaj)	-----	8 (lekë/vaskë)
6.0 TURISTIKE					
6.1	Qëllime turistike		-----	-----	8 (lekë/m ³)
6.2	Përdorim i ujit për pishina	Shoqëri private	20 (lekë/m ³)	40 (lekë/m ³)	80 (lekë/m ³)
7 PËR SHFRYTËZIM MATERIALESH INERTE					
7.1	Shfrytëzim i materialeve inerte lumore		-----	2% të vlerës së materialit të shitur	-----
7.2	Shfrytëzim i materialit rërë lumi		-----	2% të vlerës së materialit të shitur	-----

**VENDIM**

Nr. 663, datë 21.9.2016

**PËR NDRYSHIMIN, ME SHKËMBIM
NOTASH, TË MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR
REALIZIMIN E PROGRAMIT
“REHABILITIMI DHE PAJISJA E 5
POLIKLINIKAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ndryshimin, me shkëmbim notash, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit “Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

*Ambasada e Italisë
Tiranë*

Tiranë, më 9.5.2016
Prot. 1849

NOTË VERBALE

Ambasada Italiane në Tiranë i paraqet komplimentet e saj Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë dhe në emër të qeverisë italiane ka nderin t’i referohet Notës Verbale të Ministrisë Shqiptare së Shëndetësisë me nr. prot. 1683, e datës 23 mars 2016, me anë të së cilës propozohet ndryshimi i shtojcës 2 të marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë, për realizimin e programit “Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave”,

nënshkruar në Tiranë, më 17 mars 2004.

Ambasada Italiane në Tiranë ka nderin të komunikojë, që Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar ka pranuar, në emër të qeverisë italiane, të ndryshojë marrëveshjen e lartpërmendur, në bazë të nenit 13 të saj, si më poshtë specifikohet:

“Emërtimi “*Ministria e Punëve të Jashtme*” zëvendësohet me “*Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar*””.

Shkurtimi “MAE” zëvendësohet me shkurtimin “MAECI”.

Shtojca 2 - Kontratë shërbimi, furnizimi dhe punësh (kushtet e veçanta).

Fjala e paragrafit të dytë: “*Përqindja e kredisë së ndihmës të përdorur për kostot lokale dhe/ose vendet në zhvillim, nuk mund të kalojë 45% të kredisë*” zëvendësohet me frazën “*Përqindja e kredisë së ndihmës të përdorur për kosto lokale dhe/ose vendet OCSE, nuk mund të kalojë 70% të kredisë*”.

Në pajtim me përcaktimet e neneve 13 dhe 14 të marrëveshjes së mësipërme, ndryshimet e lartpërmendura do të hyjnë në fuqi nga data e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet e parashikuara me të cilat palët nënshkruese do t’i komunikojnë zyrtarisht njëra-tjetrës përfundimin e procedurave kombëtare të ratifikimit të parashikuara sipas nevojës.

Ambasada Italiane në Tiranë përfiton nga rasti për t’i përsëritur Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë ndjenjat e konsideratës së saj më të lartë.

(Vulë dhe firmë)

Ministrisë së Shëndetësisë
Për dijeni: Kryeministrisë
Ministrisë së Punëve të Jashtme
Ministrisë së Financave
Tiranë

VENDIM

Nr. 664, datë 21.9.2016

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË Z. ILIR OHRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 33, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve



shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Ilir Ohri, në masën 4 600 000 (katër milionë e gjashtëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 665, datë 21.9.2016

PËR EKSPORTIN DHE IMPORTIN E KIMIKATEVE TË RREZIKSHME²

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objektivi i këtij vendimi është i njëjtë me objektivin e Konventës së Roterdamit, të miratuar me ligjin nr. 10277, datë 13.5.2010, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit “Mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare””.

2. Ky vendim zbatohet për kimikatet industriale, pesticidet dhe biocidet, të cilat janë të ndaluara ose

të kufizuara nga legjislacioni në fuqi për t’u prodhuar, për t’u vendosur në treg dhe për t’u përdorur, për arsye të rrezikut që paraqesin në shëndet dhe mjedis.

3. Ky vendim nuk zbatohet për fushat e përcaktuara në pikën 7, të nenit 4, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

4. Ky vendim përcakton masat administrative lidhur me:

4.1 procedurën e njoftimit të eksportit të kimikateve të rrezikshme ndërmjet palëve dhe çdo shteti tjetër, si edhe listën e kimikateve dhe artikujve të rrezikshëm që i nënshtrohen njoftimit të eksportit;

4.2 procedurën e Informimit të Pëlqimit Paraprak (PIC) për disa kimikate të rrezikshme dhe pesticide në tregtinë ndërkombëtare, si edhe listën e kimikateve dhe artikujve të rrezikshëm që i nënshtrohen Procedurës së Informimit të Pëlqimit Paraprak (PIC).

5. Bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij janë:

a) Shtojca I: Lista e kimikateve dhe artikujve të rrezikshëm, që përbëhet nga tri pjesë:

i) Pjesa 1 - Lista e kimikateve (kimikatet industriale, produktet biocide dhe pesticide që nuk janë pjesë e Konventës), të cilat, për shkak të vetive të tyre të rrezikshme dhe rreziqeve që paraqesin për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, i nënshtrohen procedurës së Njoftimit të Eksportit;

ii) Pjesa 2 - Lista e kimikateve që janë kualifikuar për t’iu nënshtrohur Procedurës së Informimit të Pëlqimit Paraprak (PIC);

iii) Pjesa 3 - Lista e kimikateve që janë pjesë e Konventës dhe që i nënshtrohen procedurës PIC.

Kimikatet e listuara në shtojcën I bëjnë pjesë në një ose më shumë nga tri grupet e emëtuara, si pjesa 1, pjesa 2 dhe pjesa 3.

b) Shtojca II: Format i njoftimit të eksportit;

c) Shtojca III: Format i kërkesës për kryerjen e procedurës PIC;

ç) Shtojca IV: Lista e kimikateve dhe artikujve të rrezikshëm që ndalohen të eksportohen;

d) Shtojca V: Informacioni që Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (AKP) duhet t’i dërgojë Sekretariatit të Konventës, referuar kreut V të këtij vendimi;

dh) Shtojca VI: Njoftimi i Sekretariatit të Konventës për një kimikat të ndaluar ose rreptësisht të kufizuar.

² Ky vendim përaftron plotësisht Rregulloren (KE) nr. 649/2012 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, të datës 4 korrik 2012, në lidhje me eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme, CELEX: 32012R0649



6. Për qëllime të këtij vendimi, të gjithë termat kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Kimikat”, një substancë ose një përzierje substancash, e prodhuar apo e përfutur nga natyra, pa përfshirë organizmat e gjallë që i përkasin kategorive të mëposhtme:

i) Pesticide, duke përfshirë disa formulime të rrezikshme pesticidesh;

ii) Kimikatet industriale.

b) “Artikull”, një produkt i përfunduar, që përmban ose përfshin një kimikat, përdorimi i të cilit është i ndaluar ose rreptësisht i kufizuar në vend.

c) “Pesticide”, kimikate që bëjnë pjesë në një nga nënkategoritë e mëposhtme:

i) Pesticide si produkte të mbrojtjes së bimëve;

ii) Pesticide të tjera, si produkte biocide, dezinfektantë, insekticide dhe paraziticide.

ç) “Kimikat industrial”, kimikati që bën pjesë në një nga nënkategoritë e mëposhtme:

i) kimikat për përdorim profesional nga ente industriale, tregtare ose ndërmarrje të ndryshme;

ii) kimikat për përdorim nga publiku i gjerë.

d) “Kimikat që i nënshtrohet njoftimit për eksport”, çdo kimikat i listuar në shtojcën 1, që është i ndaluar ose rreptësisht i kufizuar brenda vendit, i cili i përket një ose disa kategorive apo nënkategorive

dh) “Kimikat i ndaluar”, një kimikat:

i) të gjitha përdorimet e të cilit brenda një ose më shumë kategorive apo nënkategorive janë ndaluara me masa rregullatore përfundimtare, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose mjedisit;

ii) miratimi i të cilit është refuzuar për t’u përdorur për herë të parë apo është tërhequr nga tregu vendas, nga industria ose gjatë shqyrtimit në procesin e regjistrimit ose miratimit dhe kur ka evidenca se ky kimikat përbën rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisit.

e) “Kimikat rreptësisht i kufizuar”, një kimikat, të gjitha përdorimet e të cilit, virtualisht:

i) brenda një ose më shumë kategorive apo nënkategorive, janë ndaluar me masa rregullatore përfundimtare, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose mjedisin, por për të cilin lejohen vetëm disa përdorime specifike;

ii) janë refuzuar të miratohen ose industria e ka tërhequr nga tregu vendas apo gjatë shqyrtimit të mëtejshëm në procesin e njoftimit, regjistrimit ose miratimit dhe kur ka të dhëna se ky kimikat përbën rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisin.

ë) “Masë rregullatore përfundimtare”, një akt ligjor ose nënligjor i posaçëm, referuar krerëve V e VI, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, dhe legjislacionit në fuqi për biocidet dhe pesticidet, që ka si qëllim ndalimin ose kufizimin e rreptë të një kimikati për t’u prodhuar, vendosur në treg dhe përdorur brenda vendit, përfshirë edhe ndalimet dhe kufizimet e parashikuara në këtë vendim.

f) “Formulim i pesticideve shumë të rrezikshme”, një kimikat i krijuar/formuluar për përdorim si pesticid që shkakton efekte të rënda, të dukshme, në shëndet ose në mjedis brenda një periudhe të shkurtër kohe, si pasojë e një ekspozimi të vetëm ose të shumëfishtë, në bazë të kushteve të përdorimit.

g) “Eksport”:

i) eksporti i përhershëm ose i përkohshëm i një kimikati që plotëson kushtet e nenit 23(2), të TFEU³;

ii) rieksporim i një kimikati që nuk plotëson kushtet e nenit 23(2), të TFEU-së, i cili i është nënshtruar një procedure tjetër doganore, të ndryshme nga procedura e transitit të jashtëm për lëvizjen e lirë të mallrave përmes territorit doganor të Shqipërisë.

gj) “Import”, kalimi i një kimikati, i cili i është nënshtruar një procedure tjetër doganore, të ndryshme nga procedura e transitit të jashtëm për lëvizjen e lirë të mallrave përmes territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

h) “Eksportues”, një nga personat fizikë ose juridikë:

i) në emër të të cilit është bërë një deklaratë eksporti, që do të thotë personi, i cili, në kohën kur deklarata është pranuar, mban kontratën e marrësit të ngarkesës në një shtet tjetër dhe ka fuqinë për të përcaktuar që lënda kimike të dërgohet jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

ii) i cili, në rastin kur kontrata e eksportit nuk është përfunduar ose kur mbajtësi i kontratës nuk vepron në emrin e vet, ka fuqinë për të përcaktuar

³<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:12012E/TXT&from=EN>



që lënda kimike të dërgohet jashtë territorit doganor të Shqipërisë;

iii) ku përfitimi i së drejtës për të depozituar një kimikat i përket një personi të krijuar jashtë Shqipërisë, sipas kontratës në të cilën bazohet eksporti, dhe ku pala kontraktuese është krijuar në Shqipëri.

i) “Importues”, çdo person fizik apo juridik që merr kimikatin, në kohën e importit, në territorin doganor të Shqipërisë.

j) “Përgjigje importi”, përgjigjja përfundimtare ose e përkohshme e importit, që lejon ose refuzon apo lejon nën kushte të caktuara, importin e ardhshëm të disa kimikateve dhe pesticideve të rrezikshme në tregtinë ndërkombëtare, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe që i komunikohet Sekretariatit të Konventës.

k) “Procedura PIC”, procedura e informimit të pëlqimit paraprak, një mekanizëm për marrjen, zyrarisht, dhe shpërndarjen e vendimeve të importit/pëlqimin eksplicit nga palët importuese, nëse ato lejojnë apo jo importin e ardhshëm të kimikateve të caktuara të rrezikshme në vendin e tyre.

l) “Pëlqim eksplicit”, konfirmimi i pëlqimit që lejon ose jo importin/eksportin nga/në një vend palë, të një kimikati ose artikulli, në varësi të kategorisë së përdorimit të tij, i shprehur në formë të shkruar nga Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar.

ll) “Njoftim eksporti”, një mekanizëm që bën të mundur shkëmbimin e informacionit ndërmjet vendeve rreth kimikateve, të cilat janë të ndaluara apo rreptësisht të kufizuara. Njëpërmjet këtij njoftimi, pala eksportuese njofton palën importuese se drejt vendit të saj është duke u eksportuar një ngarkesë e një kimikati, i cili, në vendin eksportues është i ndaluar ose rreptësisht i kufizuar.

m) “Palë në Konventë” ose “Palë”, një shtet ose një organizatë rajonale e integritit ekonomik që ka rënë dakord për t’u detyruar nga kjo konventë dhe për të cilat konventa është në fuqi.

n) “Shtet tjetër”, çdo shtet që nuk është palë në Konventë.

nj) “Sekretariat”, Sekretariati i Konventës, nëse nuk është specifikuar ndryshe në këtë vendim.

o) “Dokument udhëzues (DGD)”, udhëzuesi i miratuar nga Konferenca e Palëve të Konventës së Roterdamit dhe që u vihet në dispozicion palëve nga Sekretariati i Konventës për t’i ndihmuar në

vendimmarrje. DGD-ja udhëzon palët të vlerësojnë, sipas kushteve lokale, rreziqet lidhur me trajtimin dhe përdorimin e çdo kimikati të listuar në pjesën 3, të shtojcës I, të këtij vendimi, mbi bazën e të cilit përgatiten përgjigjet e importit, sipas kategorisë së përdorimit të çdo substance.

KREU II

PËRGJEGJËSITË E AUTORITETIT KOMBËTAR TË PËRCAKTUAR (AKP) DHE DETYRIMET NDAJ KONVENTËS

1. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (AKP), i referuar në pikën 4, të nenit 6, të ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, është përgjegjës për:

a) dërgimin e njoftimeve të eksportit drejt vendeve palë dhe zbatimin e procedurës PIC, në përputhje me përcaktimet në krerët IV e VI, të këtij vendimi;

b) dorëzimin, në Sekretariatin e Konventës, të njoftimeve për masat përkatëse rregullatore përfundimtare, në lidhje me kimikatet që i nënshtrohen procedurës PIC, në përputhje me pikën 6, të këtij kreu;

c) dërgimin, në Sekretariatin e Konventës, të informacionit në lidhje me masa të tjera rregullatore përfundimtare, që përfshijnë kimikate që nuk i nënshtrohen procedurës PIC, sipas Konventës, në përputhje me pikën 7, të këtij kreu;

ç) dërgimin, në Sekretariatin e Konventës, të përgjigjeve të importit për kimikatet që i nënshtrohen procedurës PIC, në përputhje me pikën 8, të këtij kreu;

d) marrjen e informacionit të përgjithshëm nga Sekretariati i Konventës.

2. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar koordinon çështjet teknike, që lidhen me:

a) Konventën;

b) përgatitjen e Konferencës së Palëve, e përcaktuar në nenin 18(1), të Konventës;

c) Komitetin e Rishikimit të Kimikateve, të krijuar në përputhje me nenin 18 (6), të Konventës;

ç) organet e tjera ndihmëse të Konferencës së Palëve.

3. AKP-ja ndërmerr iniciativat e nevojshme për të siguruar përfaqësimin e duhur të Shqipërisë në organet e ndryshme zbatuese të Konventës.

4. AKP-ja, nëpërmjet Zyrës së Kimikateve, kryen detyrat administrative, monitoruese dhe raportuese, si më poshtë vijon:



a) Mban, zhvillon më tej dhe përditëson rregullisht regjistrin për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme, “Regjistri eksport-import”;

b) Vendos në dispozicion dhe publikon regjistrin eksport-import në faqen e ministrisë;

c) Kur është e përshtatshme, siguron asistencë, udhëzime shkencore e teknike dhe mjete për industrinë, në mënyrë që të sigurojë zbatimin efektiv të Konventës dhe zbatimin e këtij vendimi;

ç) Merr pjesë aktive në veprimtaritë ndërkombëtare për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e kimikateve.

5. AKP-ja, me hyrjen në fuqi të masës rregullatore përfundimtare, referuar në shkronjën “ë”, të pikës 6, të kreut I, të këtij vendimi, dhe jo më vonë se 90 ditë pas datës në të cilën masa rregullatore përfundimtare fillon që të zbatohet, i njofton, me shkrim, Sekretariatit të Konventës, kimikatet e listuara në pjesën 2, të shtojcës 1, që kualifikohen për t’iu nënshtruar procedurës PIC, si më poshtë vijon:

a) Njoftimi në Sekretariat, i kimikateve të kualifikuara për t’iu nënshtruar procedurës PIC përmban të gjithë informacionin e përcaktuar në shtojcën IV, të Konventës së Roterdamit;

b) Kur informacioni më sipër është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kërkesat e shtojcës IV, të Konventës së Roterdamit, me kërkesë të Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar, eksportuesi ose importuesi, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, siguron informacionin e duhur që ka në dispozicion, përfshirë edhe atë nga programe të tjera kombëtare ose ndërkombëtare të certifikuara për kontrollin e kimikateve;

c) Kur një masë rregullatore përfundimtare ndryshon, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar njofton Sekretariatin me shkrim, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se 60 ditë nga data në të cilën masa e re rregullatore përfundimtare hyn në fuqi;

ç) Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar, me kërkesë të çdo vendi Palë ose Sekretariatit, siguron informacione shtesë për kimikatet ose masat rregullatore përfundimtare, për sa kohë është praktikisht e mundur.

6. AKP-ja informon Sekretariatin për kimikatet e ndaluara ose rreptësisht të kufizuara që gjenden në pjesën 1, të shtojcës I, bashkëlidhur këtij

vendimi, dhe që nuk kualifikohen për njoftimin PIC, me qëllim shpërndarjen e informacionit të palët e tjera të Konventës.

7. AKP-ja përgatit një përgjigje importi përfundimtare ose të përkohshme, bazuar në legjislacionin në fuqi, lidhur me importet e ardhshme të kimikateve në Republikën e Shqipërisë, që i nënshtrohen procedurës PIC, dhe ia komunikon atë Sekretariatit, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se nëntë muaj pas datës së dërgimit të dokumentit udhëzues për vendimmarrje (DGD) nga Sekretariati, si më poshtë vijon:

a) AKP-ja harton përgjigjen për importin përfundimtar ose të përkohshëm, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për biocidet dhe ministrinë përgjegjëse për pesticidet. Vendimi i komunikohet Sekretariatit nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme;

b) Në rastin kur kimikati bëhet subjekt i kufizimeve shtesë ose ndryshimit të kufizimeve në Republikën e Shqipërisë, AKP-ja miraton një përgjigje importi të rishikuar dhe ia komunikon atë Sekretariatit;

c) Referuar shkronjës “a”, të kësaj pike, përgjigjja e importit lidhet me kategorinë ose kategoritë e specifikuara për kimikatin në dokumentin udhëzues të Sekretariatit;

ç) AKP-ja, kur komunikon përgjigjen e importit në Sekretariat, e shoqëron atë me një përmbledhje të masave ligjore ose administrative në vend, mbi të cilat është bazuar për përgatitjen e përgjigjes së importit;

d) AKP-ja publikon, nëpërmjet faqes zyrtare, përgjigjet e importit për çdo kimikat në fjalë.

KREU III

KIMIKATET SUBJEKT I NJOFTIMIT TË EKSPORTIT DHE KIMIKATET SUBJEKT I PROCEDURËS SË INFORMIMIT TË PËLQIMIT PARAPRAK (PIC)

1. Kimikatet subjekt i procedurës së njoftimit të eksportit, referuar kreut IV, të këtij vendimi janë:

1.1 Të gjitha kimikatet e listuara në pjesën 1, të shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi;

1.2 Artikujt, në qoftë se përmbajnë:

a) substanca në formë jovepruese, të përfshira në pjesët 2 e 3, të shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi;



b) Përzierje, të cilat përmbajnë kimikate të tilla që përqendrimi i tyre cenon/prek detyrimet e etiketimit, sipas legjislacionit specifik për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin.

2. Çdo kimikat, subjekt i procedurës së njoftimit të eksportit, shoqërohet me informacionin e dhënë në mënyrë të detajuar, për:

i) identitetin e substancës që gjendet në kimikat dhe që është subjekt njoftimi;

ii) kategorinë e përdorimit dhe/ose nënkategorinë për të cilin kufizohet;

iii) llojin e kufizimit dhe, sipas rastit;

iv) informacione shtesë, në veçanti për çdo kërkesë për njoftim eksporti.

3. Kimikatat e listuara në pjesën 2, të shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi, kualifikohen për t'iu nënshtruar procedurës PIC. Këto kimikate do t'i nënshtrohen procedurës PIC vetëm pas hyrjes në fuqi të masës rregullatore përfundimtare, sipas përcaktimit në shkronjën “ë”, të pikës 6, të kreut I, të këtij vendimi.

4. Kimikatat e listuara në pjesën 3, të shtojcës I, i nënshtrohen procedurës PIC sipas kategorisë së dhënë të përdorimit.

5. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar vë në dispozicion të publikut listën e kimikateve, të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, nëpërmjet publikimit të tyre në faqen elektronike të ministrisë.

KREU IV

PROCEDURA E NJOFTIMIT TË EKSPORTIT TË KIMIKATEVE NGA AKP-ja TE PALËT DHE NGA PALËT TEK AKP-ja

1. Për kimikatat e listuara në pjesën 1, të shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi ose përzierjet që përmbajnë substanca në përqendrime të tilla, që përcaktojnë detyrimet për etiketim sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, zbatohen kërkesat e mëposhtme të njoftimit të eksportit, pavarësisht pranisë së ndonjë substance tjetër apo qëllimit të përdorimit të kimikatit në shtetin importues.

2. Eksportuesi, që ka për qëllim të eksportojë për herë të parë një kimikat në një palë ose në një shtet tjetër, harton njoftimin e eksportit, në përputhje me kërkesat e informacionit, të parashikuar në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi dhe e dorëzon tek Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar. Procedura ndjek hapat, si më poshtë

vijon:

a) Eksportuesi e njofton Autoritetin Kombëtar të Përcaktuar, jo më vonë se 35 ditë përpara datës së parashikuar të eksportit për herë të parë. Eksportuesi njofton AKP-në çdo vit kalendarik për eksportin e parë të kimikatit për atë vit kalendarik, jo më vonë se 35 ditë përpara datës së parashikuar të eksportit;

b) Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar konfirmon, brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit të eksportit, nëse njoftimi është i plotë dhe në përputhje me informacionin e shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi. Në rastin kur njoftimi është i plotë, AKP-ja e përcjell njoftimin tek Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar i Palës importuese, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parashikuar të eksportit të parë të kimikateve dhe jo më vonë se 15 ditë përpara eksportit të parë në çdo viti pasues kalendarik.

c) Nëse njoftimi i eksportit nuk është i plotë, eksporti i kimikatit nuk lejohet. AKP-ja njofton eksportuesin për plotësimin e informacionit të nevojshëm, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, me qëllim njoftimin e palës importuese brenda afateve të përcaktuara në shkronjën “b”, të kësaj pikë dhe kryerjen e eksportit në kohën e përcaktuar;

ç) Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar regjistron çdo njoftim eksporti dhe i cakton një numër identifikimi reference (RIN) në *database*. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar vendos në dispozicion të publikut dhe të palëve importuese listën e përditësuar të kimikateve, për të cilat është kryer njoftimi i eksportit për çdo vit kalendarik. Metodologjia e vendosjes së numrit të identifikimit të referencës miratohet me urdher të ministrit përgjegjës për mjedisin.

3. Nëse Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar nuk merr një konfirmim për marrjen e njoftimit të eksportit të parë (*acknowledgment receipt*) nga pala importuese, brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të tij, AKP-ja dërgon një njoftim të dytë tek AKP-ja e palës importuese.

4. Njoftimi i ri i eksportit kryhet në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij kreu, për eksportet, të cilat ndodhin pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në legjislacionin për kufizimet në prodhim, vendosjen në treg dhe përdorimin, si dhe legjislacionin për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin, në lidhje me substancat në fjalë ose



kur përbërja e përzierjes në fjalë ndryshon në mënyrë të tillë që ndryshon dhe etiketimi i përzierjes. Njoftimi i ri kryhet në përputhje me kërkesat e informacionit të përcaktuar në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi dhe AKP-ja duhet të tregojë se njoftimi i ri është rishikim i një njoftimi të mëparshëm.

5. Në rastin kur eksporti i një kimikati lidhet me një situatë emergjence shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi në vendin e eksportit/importit apo legjislacionit ndërkombëtar, ku Republika e Shqipërisë është palë, në të cilën çdo vonesë mund të rrezikojë shëndetin publik ose mjedisin e palës importuese, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar, bazuar në kërkesën e arsyetuar të eksportuesit ose të palës importuese, mund të marrë vendimin për një përjashtim të pjesshëm ose të plotë nga detyrimet e parashikuara në pikat 2, 3 e 4, të këtij kreu.

6. Pavarësisht detyrimeve të përcaktuara në pikën 4, të kreut IX, të këtij vendimi, detyrimet për njoftimin, sipas përcaktimeve në pikat 2 deri në 4, të këtij kreu, nuk zbatohen në rastin kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Kimikati i nënshtrohet procedurës PIC;

b) Në përputhje me pikën 2, të nenit 10, të Konventës, vendi importues i ka dërguar Sekretariatit një përgjigje importi, duke informuar lejimin ose jo të importit të kimikateve;

c) Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar është informuar nga ana e Sekretariatit për atë përgjigje.

6.1 Pavarësisht përcaktimit të pikës 6, më lart, detyrimet e përcaktuara në pikat 2 deri në 4, të këtij kreu, zbatohen në rastin kur Pala importuese kërkon, në mënyrë të drejtpërdrejtë, njoftim të vazhdueshëm të eksportit nga Palët eksportuese, me anë të përgjigjes të saj të importit ose e shprehur ndryshe.

6.2 Pavarësisht detyrimeve të përcaktuara në pikën 4, të kreut IX, të këtij vendimi, detyrimet e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të këtij kreu, nuk zbatohen në rastin kur plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

a) Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar i Palës importuese ka hequr dorë nga kërkesa që duhet të njoftohet para eksportit të kimikateve;

b) Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar ka qenë në dijeni të kësaj përgjigjeje nga Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar i palës importuese ose nga Sekretariati.

7. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar dhe eksportuesit, sipas kërkesës, pajisin palët importuese me informacionet shitesë në dispozicion, që lidhen me kimikatet e eksportuara.

8. Eksportuesit paguajnë tarifën administrative për çdo njoftim eksporti të bërë dhe për çdo kërkesë shprehjeje pëlqimi eksplisit të bërë, që korrespondon me kryerjen e procedurave të përcaktuara në pikat 2, shkronja “a”, dhe 4, të këtij kreu, dhe në pikat 5 deri në 10, të kreut VI, të këtij vendimi. Tarifat administrative miratohen në përputhje me përcaktimet e nenit 44, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

9. Kur AKP-ja merr një njoftim eksporti nga një palë apo shtet tjetër, lidhur me eksportin e një kimikati në Republikën e Shqipërisë, prodhimi, përdorimi, vendosja në treg e të cilit është e ndaluar apo rreptësisht i kufizuar në vendin e origjinës, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, AKP-ja i përgjigjet AKP-së së palës eksportuese për marrjen e njoftimit, sipas formatit të shtojcës II/2, të këtij vendimi, të hartuar nga Sekretariati i Konventës dhe të publikuar në *website-in* e Konventës.

KREU V

INFORMACIONI PËR KIMIKATET E EKSPORTUARA DHE TË IMPORTUARA

1. Çdo eksportues i një ose më shumë:

a) substancave, të listuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) përzierjeve që përmbajnë substanca në përqendrime të tilla, që përcaktojnë detyrimet për etiketimin e kimikateve sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve;

c) artikujve, që përmbajnë substanca në formë jovepruese, të listuara në pjesët 2 e 3, të shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi ose përzierjet që përmbajnë substanca në përqendrime të tilla, që përcaktojnë detyrimet për etiketimin e kimikateve sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, gjatë tremujorit të parë të çdo viti, informon Autoritetin Kombëtar të Përcaktuar në lidhje me sasinë e kimikateve, që gjenden në formën e një substance dhe si përbërës në një përzierje ose artikull, të eksportuar te çdo palë apo shtet tjetër gjatë vitit të mëparshëm kalendarik.



2. Ky informacion jepet së bashku me një listë të emrave dhe adresave të çdo personi fizik apo juridik që i importon këto kimikate në vendin palë, drejt të cilit ka ndodhur eksporti i kimikatit gjatë së njëjtës periudhë.

3. Informacioni për çdo eksport të kimikateve të listuara në pjesët 2 e 3, të shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi, që është kryer pa marrjen e pëlqimit eksplicit nga vendi importues, listohet në mënyrë të ndarë, në përputhje me pikat 7 dhe 12, të kreut VI, të këtij vendimi.

4. Çdo importues, brenda Republikës së Shqipërisë, raporton pranë AKP-së të njëjtin informacion për sasitë e importuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij kreu.

5. Me kërkesë të Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar, eksportuesi ose importuesi siguron çdo informacion shtesë për kimikatet, të nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

6. AKP-ja grumbullon informacionin e marrë nga eksportuesit dhe importuesit dhe e përshtat sipas formatit të përcaktuar në shtojcën V, të këtij vendimi. Informacioni raportohet pranë Sekretariatit të Konventës dhe një përmbledhje e informacionit jokonfidencial publikohet në *website*-in e ministrisë. Informacioni që përfshihet në publikim përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

KREU VI PROCEDURA E INFORMIMIT TË PËLQIMIT PARAPRAK (PIC)

1. AKP-ja transmeton te personat e interesuar, brenda Republikës së Shqipërisë, informacionin e marrë nga Sekretariati i Konventës, qoftë në formën e qarkoreve (PIC Circulars) ose ndryshe, lidhur me kimikatet që i nënshtrohen procedurës PIC, përgjigjet e importit të palëve dhe kushtet e importit të këtyre kimikateve. Qarkoret publikohen në *website*-in e ministrisë.

2. Për çdo përgjigje importi të palës/ëve importuese, AKP-ja përcakton një numër identifikimi, të cilin e vë në dispozicion të të interesuarve nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik, dhe ia vë në dispozicion çdo personi tjetër, me kërkesë të tij.

3. Eksportuesit përmbushin kushtet e përcaktuara në vendimet e importit të palëve importuese, jo më vonë se gjashtë muaj pasi

Sekretariati ka informuar për herë të parë AKP-në për këto vendime (PIC Circulars).

4. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar, për çdo kimikat të listuar në të tria pjesët e shtojcës I, përcakton një klasifikim, të bazuar në kodet tarifore të kimikateve të rrezikshme, sipas nomenklaturës së kombinuar të mallrave në fuqi në momentin e importit/eksportit.

5. Substancat e listuara në pjesën 3, të shtojcës I, ose përzierjet që përmbajnë substanca në përqendrim të tillë, që përcaktojnë detyrimet për etiketimin e kimikateve sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, pavarësisht pranisë së ndonjë substance tjetër, si dhe qëllimit të përdorimit në Palën importuese, eksportohen vetëm nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Eksportuesit i është dhënë pëlqimi eksplicit i importit nga AKP-ja e palës importuese;

b) Qarkorja e fundit e nxjerrë nga Sekretariati për kimikatet e pjesës 3, të shtojcës I, sipas përcaktimit në pikën 1, të këtij kreu, tregon se pala importuese e ka dhënë pëlqimin e importit.

6. Marrja e pëlqimit eksplicit, referuar shkronjës “a”, të pikës 5, të këtij kreu, i nënshtrohet kësaj procedure:

a) Për kryerjen e eksporteve nga Republika e Shqipërisë në vendet palë apo shtete të tjera, eksportuesi kërkon marrjen e pëlqimit eksplicit nga AKP-ja e palës importuese, nëpërmjet kërkesës drejtuar AKP-së së Republikës së Shqipërisë (RSH), jo më vonë se 60 ditë përpara eksportit të parë të synuar në atë vit kalendarik, dhe jo më vonë se 30 ditë përpara eksportit të parë në çdo vit kalendarik pasardhës. Lejohet kontakti i drejtpërdrejtë i eksportuesit dhe importuesit me AKP-në e palës importuese, pas kontaktit formal të AKP-së së RSH-së me AKP-në e palës importuese.

b) Eksportuesi paraqet pranë AKP-së dokumentacionin, si më poshtë vijon:

i) Kërkesën për marrjen e pëlqimit eksplicit nga pala importuese;

ii) Informacionin e përcaktuar në shtojcat II/1 dhe III, bashkëlidhur këtij vendimi;

iii) Dokumentin me të dhënat e sigurisë kimike (*Safety DataSheet*).

c) Dokumentacioni i kërkuar sipas shkronjës “b”, të pikës 6, të këtij kreu, duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze;



ç) AKP-ja e transmeton kërkesën për marrjen e pëlqimit eksplisit pranë AKP-së së palës importuese. Nëse, brenda 30 ditëve, nuk është marrë asnjë përgjigje, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar dërgon një rikujtesë tek AKP-ja e palës importuese. Nëse, 30 ditë pas datës së dërgimit të rikujtesës, ende nuk është marrë asnjë përgjigje, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar, sipas rastit, dërgon kujtesa të tjera.

7. Për kimikatet që gjenden në pjesën 3, të shtojcës I, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar, rast pas rasti dhe bazuar në pikën 4, të këtij kreu, vendos lejimin e kryerjes së eksportit, në rastin kur të dhënat zyrtare vërtetojnë se kimikati nuk është i ndaluar ose rreptësisht i kufizuar për t'u përdorur në palën importuese (bazuar në masat rregullatore përfundimtare, qarkoret PIC), dhe, nëse 60 ditë, nga data e kërkesës, nuk është marrë pëlqimi eksplisit, referuar shkronjës “a”, të pikës 5, të këtij kreu, si edhe nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) Ka të dhëna nga burime zyrtare të palës importuese që vërtetojnë se kimikati është i licencuar, regjistruar ose autorizuar;

b) Qëllimi i përdorimit të kimikatit, i deklaruar në njoftimin e eksportit dhe i konfirmuar me shkrim nga personi fizik ose juridik që e importon atë në një vend palë, nuk i përket kategorisë për të cilën kimikati është listuar në pjesën 3, të shtojcës I, dhe se të dhënat zyrtare vërtetojnë se kimikati, në pesë vitet e fundit, është përdorur ose është importuar në palën importuese në fjalë.

8. Vendimi i lejimit të eksportit të kimikateve, sipas kushteve të referuara në pikën 7, të këtij kreu, është i vlefshëm vetëm për 12 muaj.

9. Në rastin e kimikateve që gjenden në pjesën 3, të shtojcës I, eksporti, i bazuar në plotësimin e kushtit të referuar në shkronjën “b”, të pikës 7, nuk mund të kryhet nëse kimikati është klasifikuar si kancerogjen i kategorive 1A ose 1B ose mutagjene, në kategoritë 1A ose 1B, ose toksike për riprodhimin, në kategoritë 1A ose 1B, në përputhje me legjislacionin në fuqi për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve apo kimikati plotëson kriteret për përfshirjen e substancave në listën e SVHC-ve, për të qenë të qëndrueshme, bioakumulative dhe toksike ose shumë të qëndrueshme dhe shumë bioakumulative.

10. Në momentin e marrjes së pëlqimit eksplisit për lejimin e eksportit të kimikateve që gjenden në

pjesën 3, të shtojcës I, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar merr në konsideratë edhe ndikimin e mundshëm që mund të ketë në shëndetin e njeriut ose mjedis përdorimi i kimikatit në palën importuese apo në një shtet tjetër.

11. AKP-ja jep pëlqimin eksplisit për lejimin e eksportit të kimikateve të listuara në pjesët 2 dhe 3, të shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij kreu. Format i formularit të kërkesës dhe formati i pëlqimit eksplisit për lejimin e eksportit/importit miratohen me urdhër të ministrit, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

12. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar regjistron të gjitha kërkesat e eksportuesve për pëlqim eksplisit, përgjigjet e marra për të vazhduar eksportin pa pëlqimin eksplisit. Çdo pëlqim eksplisit, të marrë nga pala importuese ose vendimi për të vazhduar pa pëlqimin eksplisit, do t'i caktohet një numër identifikues reference dhe ai do të listohet, duke u shoqëruar me të gjithë informacionin e duhur, për kushtet, të tilla si koha e vlefshmërisë. Nga informacioni i regjistruar, publikut i vihet në dispozicion vetëm informacioni me të dhëna jokonfidenciale.

13. Asnjë kimikat nuk lejohet të eksportohet më vonë se gjashtë muaj para datës së skadimit, në rastin kur një datë e tillë ekziston ose mund të nxirret nga data e prodhimit, me përjashtim të rastit nëse karakteristikat kryesore të kimikatit e bëjnë afatin e skadencës të pazbatueshëm. Në veçanti, në rastin e pesticideve, eksportuesit sigurojnë që madhësia dhe paketimi i kontejnerëve është optimizuar, në mënyrë që të reduktojë rrezikun e krijimit të stokeve të skaduara.

14. Kur eksportojnë pesticide, eksportuesit sigurojnë që etiketa të përmbajë informacionin specifik për kushtet e ruajtjes dhe qëndrueshmërinë në ruajtje, sipas kushteve klimatike të palës importuese. Përveç kësaj, eksportuesi siguron që pesticidet e eksportuara të jenë në përputhje me specifikimet e përcaktuara të pastërtisë.

15. Dhënia e pëlqimit eksplisit nga AKP-ja e RSH-së për AKP-në e vendit eksportues, me qëllim lejimin e importit të kimikateve në territorin e RSH-së, kryhet sipas kësaj procedure:

a) Me marrjen e njoftimit për dhënien e pëlqimit eksplisit nga AKP-ja e palës eksportuese, të shoqëruar me dokumentacionin e referuar në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 6, të këtij kreu,



AKP-ja e RSH-së, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për pesticidet dhe biocidet, jo më vonë se 60 ditë nga marrja e njoftimit, jep/refuzon/ose jep në mënyrë të kushtëzuar pëlqimin eksplicit;

b) Vendimi për dhënien/refuzimin ose dhënien e kushtëzuar të pëlqimit eksplicit për të importuar kryhet duke u bazuar në përgjigjet e importit, të referuara në pikën 7, të kreut II, të këtij vendimi, dhe masave rregullatore përfundimtare, të referuara në shkronjën “ë”, të pikës 6, të kreut I, të këtij vendimi.

KREU VII NDALIMI I EKSPORTIT TË KIMIKATEVE DHE ARTIKUJVE TË CAKTUAR

1. Ndalohen të eksportohen kimikatat dhe artikujt e listuar në aneksin I, të vendimit nr. 360, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”, me numër rendor, përkatësisht: 1, 2, 3, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, përdorimi i të cilave, për qëllime të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe të mjedisit, është i ndaluar brenda Republikës së Shqipërisë.

2. Ndalohen të eksportohen kimikatat dhe artikujt e listuar në shtojcën IV, të këtij vendimi, përdorimi i të cilave, për qëllime të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe të mjedisit është i ndaluar brenda Republikës së Shqipërisë.

KREU VIII INFORMACIONI PËR LËVIZJET TRANSIT DHE INFORMACIONI SHOQËRUES I KIMIKATEVE QË EKSPORTOHEN

1. AKP-ja vë në dispozicion të Sekretariatit informacionin e kërkuar nga Palët e Konventës për lëvizjet transit të kimikateve të listuara në pjesën 3, të shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Mbi bazën e kërkesës së ardhur nga Sekretariati, eksportuesi i siguron Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar informacionin e kërkuar nga Pala e Konventës jo më vonë se 30 ditë përpara kryerjes së transitit të parë dhe jo më vonë se 8 ditë përpara çdo transitit pasardhës.

3. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar e përcjell informacionin e marrë nga eksportuesi te

Sekretariati dhe Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar i Palës që e ka kërkuar këtë informacion jo më vonë se 15 ditë përpara kryerjes së transitit të parë dhe të çdo transitit pasardhës.

4. Kimikatat që synohen të eksportohen drejt një shteti palë ose ndonjë vendi tjetër u nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve ose ndonjë legjislacioni tjetër përkatës. Kërkesat e kësaj pike zbatohen, me përjashtim të rastit nëse dispozitat e etiketimit dhe ambalazhimit bien në kundërshtim me ndonjë kërkesë specifike të palës importuese ose vendeve të tjera.

5. Në etiketën e kimikateve të referuara në pikën 4, të këtij kreu ose të listuara në shtojcën I, të këtij vendimi, vendoset data e skadimit dhe data e prodhimit dhe, nëse është e nevojshme, data e skadimit jepet për zona të ndryshme klimatike.

6. Eksporti i kimikateve të referuara në pikën 4, të këtij kreu, shoqërohet me materialin për të dhënat e sigurisë, të hartuar në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi për dokumentacionin e sigurisë kimike. Eksportuesi dërgon materialin për të dhënat e sigurisë te çdo person fizik ose juridik që importon kimikate në shtetin palë ose një shtet tjetër.

7. Informacioni në etiketë dhe materiali i të dhënave të sigurisë jepet në gjuhën zyrtare ose gjuhët kryesore të shtetit importues apo zonës ku do të përdoret kimikati.

KREU IX KONTROLI I EKSPORTIT E IMPORTIT TË KIMIKATEVE DHE DETYRIME TË TJERA PËR EKSPORTUESIT

1. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 36 dhe 38, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, autoritetet doganore kontrollojnë:

a) nëse kimikati që eksportohet/importohet i nënshtrohet këtij vendimi;

b) nëse kimikati ndalohet të eksportohet, në përputhje me kreun VII, të këtij vendimi;

c) nëse në kutinë 44 të deklaratës doganore, gjendet numri referencë i identifikimit (RIN);

ç) njoftimin e eksportit dhe nëse kimikati dhe emri i vendit importues korrespondojnë me informacionin e paraqitur në njoftimin e eksportit;

d) nëse eksportuesi zotëron konfirmimin e marrjes së njoftimit nga vendi importues;



dh) nëse eksportuesi është pajisur me pëlqim eksplícit për eksport nga AKP-ja, me qëllim eksportin e kimikateve nga RSH-ja drejt një palë apo shteti tjetër;

e) nëse importuesi është pajisur me njoftimin e eksportit nga vendi eksportues;

ë) nëse importuesi është pajisur me pëlqim eksplícit importi nga AKP-ja, me qëllim importin e kimikateve në RSH nga një palë apo shtet tjetër;

f) nëse eksportuesi e kryen eksportin në përputhje me përcaktimet në pikat 13 e 14, të kreut VI, të këtij vendimi;

g) nëse eksportuesi e kryen eksportin në përputhje me përcaktimet në pikat 4, 5, 6 e 7, të kreut VIII, të këtij vendimi.

2. Eksportuesit vendosin numrat referencë të identifikimit (RIN) në deklaratën e tyre të eksportit (kutia 44 e dokumentit administrativ).

3. Referuar kreut IV, eksportuesit e kimikateve që, sipas përcaktimit të pikës 5, të këtij kreut, përjashtohen nga detyrimet e përcaktuara në pikat 2 e 4, të këtij kreut, ose të kimikateve për të cilat këto detyrime kanë mbaruar, në përputhje me pikën 6, të këtij kreut, pajisen me një numër special RIN, të cilin e përfshijnë në deklaratën e tyre të eksportit.

4. Çdo 31 mars, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave raporton pranë Zyrës së Kimikateve të dhënat e ruajtura të vitit të mëparshëm kalendarik për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme, sipas listës së paraqitur në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Të dhënat duhet të jenë individuale, sipas subjektit dhe ngarkesës.

5. Gjatë tremujorit të parë të çdo viti, eksportuesi dhe importuesi raportojnë pranë Ministrisë së Mjedisit sasitë e importuara dhe eksportuara të kimikateve të rrezikshme, sipas listës së paraqitur në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Informacioni i raportuar përfshin një listë të emrave dhe adresave të çdo importuesi/eksportuesi, nga të cilët është kryer import-eksporti.

6. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar monitoron zbatimin e detyrimeve të eksportuesve dhe importuesve, të përcaktuara në këtë vendim, duke koordinuar dhe bashkëpunuar me autoritetet doganore për shkëmbimin e informacionit.

KREU X

SHKËMBIMI I INFORMACIONIT, MONITORIMI DHE RAPORTIMI

1. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar ka për detyrë, të:

a) lehtësojë dhënien e informacionit shkencor, teknik, ekonomik dhe ligjor për kimikatet që i nënshtrohen këtij vendimi, duke përfshirë informacionin e sigurisë toksikologjike dhe ekotoksikologjike;

b) vërë në dispozicion të publikut informacionin për masat rregullatore, në zbatim të objektivave të Konventës;

c) sigurojë dhënien e informacionit për palët dhe shtetet e tjera, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Sekretariatit, për masat që kufizojnë një ose më shumë nga përdorimet e një kimikati.

2. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar mbron informacionin konfidencial që merr nga një palë apo shtet tjetër, siç është rënë, reciprocisht, dakord.

3. Në lidhje me dhënien e informacionit, referuar këtij vendimi, të paktën informacioni i mëposhtëm nuk do të konsiderohet konfidencial:

a) Informacioni i specifikuar në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe në shtojcën IV, të Konventës së Roterdamit;

b) Informacioni në materialin e të dhënave të sigurisë, përmendur në pikën 6, të kreut VIII, të këtij vendimi;

c) Data e skadimit të një kimikati;

ç) Data e prodhimit të një kimikati;

d) Informacioni për masat parandaluese, përfshirë klasifikimin e rrezikut, natyrën e rrezikut dhe këshillat përkatëse të sigurisë;

dh) Rezultatet përmbledhëse të testeve toksikologjike dhe ekotoksikologjike;

e) Informacioni në lidhje me menaxhimin e paketimit pas heqjes së kimikateve.

4. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar, çdo dy vjet përgatit një përmbledhje të informacionit të dhënë.

5. Për të siguruar monitorimin e realizimit të procedurave të parashikuara në këtë vendim, përfshirë të dhënat nga kontrolli doganor, shkeljet, jobat dhe masat e marra, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar përgatit një raport çdo tre vjet. Raporti miratohet me urdhër të ministrit dhe një përmbledhje e këtij raporti publikohet në *website*-n e ministrisë.



6. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar përcakton formatet për grumbullimin e informacionit nga autoritetet e kontrollit, prodhuesit dhe importuesit, sipas kërkesave të këtij vendimi, dhe i vë ato në dispozicion të tyre, pa pagesë, në faqen e *website*-it të Ministrisë. Formatet e informacionit, që plotësojnë eksportuesit/importuesit dhe autoritetet e kontrollit, miratohen me urdhër të ministrit.

7. Në lidhje me informacionin e siguruar sipas pikës 5, të këtij kreu, Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar ruan konfidencialitetin dhe pronësinë e të dhënave.

KREU XI PËRDITËSIMI I SHTOJCAVE

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin monitoron ndryshimet e masave rregullatore dhe zhvillimet që ndodhin në Konventë, lidhur me listën e kimikateve në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Me qëllim përshtatjen e këtij vendimi me progresin teknik, ministria i propozon Këshillit të Ministrave amendimet, për:

a) përfshirjen e një kimikati në pjesët 1 ose 2, të shtojcës I, menjëherë pas miratimit të masave rregullatore përfundimtare, në kuadër të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe ndryshimeve që bëhen në shtojcën I, përfshirë modifikimet për kimikatet ekzistuese;

b) përfshirjen e një kimikati që i nënshtrohet legjislacionit mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm, në shtojcën I, të vendimit nr. 360, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”;

c) përfshirjen e një kimikati të ndaluar për eksport dhe/ose modifikimet e kimikateve ekzistuese, referuar në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi;

ç) rishikimet e shtojcave II, III, IV.

KREU XII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Mospërbushja e kërkesave të këtij vendimi përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen sipas pikave 29, 30, 31 e 32, të nenit 40, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet juridike me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



SHTOJCA I
LISTA E KIMIKATEVE DHE ARTIKUJVE TË RREZIKSHËM

PJESA 1
Lista e kimikateve që janë objekt i procedurës së Njoftimit të Eksportit

Në rastin kur kimikatet e listuara në këtë Pjesë të Shtojcës I, i nënshtrohen procedurës PIC, detyrimet për Njoftimin e Eksportit të parashikuara në Pikën 2, 3 dhe 4 të Kreut IV të këtij vendimi, nuk do të zbatohen me kusht që të plotësohen kushtet e përcaktuara në pikat (b) dhe (c) të nënparagrafit të parë të pikës 6, të Kreut IV të këtij vendimi. Kimikate të tilla të cilat në listën më poshtë janë identifikuar nëpërmjet simbolit '(#)', për lehtësi reference janë listuar edhe në Pjesën 3, të kësaj Shtojce.

Në rastin kur kimikatet e listuara në këtë Pjesë të Shtojcës I, kualifikohen për Njoftimin PIC për shkak të natyrës së masave rregullatore përfundimtare në Republikën e Shqipërisë, këto kimikate gjenden edhe në Pjesën 2 të kësaj Shtojce. Kimikate të tilla janë identifikuar në listën më poshtë nëpërmjet simbolit '(+)'.

Nr.	KIMIKATI	Nr. CAS	Nr. EINECS	KODI N.DOGANORE ^(*)	KODI TARIFOR SIPAS NK DOGANORE 2016	NENKATEGORIA ⁽¹⁾	KUFIZIMI I PERDORIMIT ⁽²⁾	Shtetet për të cilat nuk kërkohet Njoftim
1.	1,1 Dikloreteni	75-35-4	200-864-0	Ex 2903 29 00	2903 29 00	i (2)	rr k	
2.	1,1,1-Trikloretani	71-55-6	200-756-3	2903 19 10	2903 19 00	i(2)	n	
3.	1, 1,2-Trikloretani	79-00-5	201-166-9	Ex 2903 19 80	2903 19 00	i (2)	rr k	
4.	1, 1,1, 2- Tetrakloretani	630-20-6	211-135-1	Ex 2903 19 80	2903 19 00	i (2)	rr k	
5.	1, 1,2, 2- Tetrakloretani	79-34-5	201-197-8	Ex 2903 19 80	2903 19 00	i (2)	rr k	
6.	1,2-Dibrometani (Etilene dibromidi) (#)	106-93-4	203-444-5	2903 31 00	2903 31 00	p(1)-p(2)	n-n	Lutemi referojuni Qarkores PIC ne www.pic.int
7.	1,2-Dikloretani (Etilen dikloridi) (#)	107-06-2	203-458-1	2903 15 00	2903 15 00	p(1)-p(2) i(2)	n-n n	Lutemi referojuni Qarkores PIC ne www.pic.int
8.	Cis- 1,3-diklorpropeni ((1Z)-1,3-diklorprop-1-eni)	10061-01-5	233-195-8	2903 29 00	2903 29 00	p(1)-p(2)	n-n	
9.	1,3-dikloropropeni ⁽³⁾ (+)	542-75-6	208-826-5	2903 29 00	2903 29 00	p(1)	n	
10.	2-aminobutani	13952-84-6	237-732-7	2921 19 80	2921 19 99	p(1)-p(2)	n-n	
11.	2-Naftilamine (naftalen-2-amina) dhe kriperat e tij (+)	91-59-8, 553-00-4, 612-52-2 dhe të tjera	202-080-4, 209-030-0, 210-313-6 dhe të tjera	2921 45 00	2921 45 00	i(1) i(2)	n n	
12.	Acid 2-Naftiloksiacetik	120-23-0	204-380-0	2918 99 90	2918 99 90	p(1)	n	



13.	2,4,5-T kriperat dhe esteret e tij (#)	93-76-5 dhe te tjera	202-273-3 dhe te tjera	2918 91 00	2918 91 00	p(1)-p(2)	n-n	Lutemi referojuni Qarkores PIC ne www.pic.int
14.	4-Aminobifenil (bifenil-4-amine) dhe kriperat e tij (+)	92-67-1, 2113-61-3 dhe te tjera	202-177-1 dhe te tjera	2921 49 80	2921 49 00	i(1) i(2)	n n	
15.	4-Nitrobifenil (+)	92-93-3	202-204-7	2904 20 00	2904 20 00	i(1) i(2)	n n	
16.	Acefate(+)	30560-19-1	250-241-2	2930 90 85	2930 90 99	p(1)-p(2)	n-n	
17.	Acifluorfen	50594-66-6	256-634-5	2916 39 90	2916 39 90	p(1)-p(2)	n-n	
18.	Alaklor (+)	15972-60-8	240-110-8	2924 29 95	2924 29 98	p(1)	n	
19.	Aldikarb(+)	116-06-3	204-123-2	2930 90 85	2930 90 99	p(1)-p(2)	rr.k-n	
20.	Ametrin	834-12-8	212-634-7	2933 69 80	2933 69 80	p(1)-p(2)	n-n	
21.	Amitraz(+)	33089-61-1	251-375-4	2925 29 00	2925 29 00	p(1)-p(2)	n-n	
22.	Antrakuinon (+)	84-65-1	201-549-0	2914 61 00	2914 61 00	p(1)-p(2)	n-n	
23.	Komponime te Arsenikut					p(2)	rr.n	Lutemi referojuni Qarkores PIC ne www.pic.int
24.	Fibra te Asbestit (+):	1332-21-4 dhe te tjera						
	Krocidolit (#)	12001-28-4		2524 10 00	2524 10 00	i	n	
	Amosit (#)	12172-73-5		2524 90 00	2524 90 00	i	n	
	Antofillit (#)	77536-67-5		2524 90 00	2524 90 00	i	n	
	Aktinolit (#)	77536-66-4		2524 90 00	2524 90 00	i	n	
	Tremolit (#)	77536-68-6		2524 90 00	2524 90 00	i	n	
	Krisotil (+)	12001-29-5 ose 132207-32-0		2524 90 00	2524 90 00	i		
25.	Atrazine (+)	1912-24-9	217-617-8	2933 69 10	2933 69 10	p(1)	n	
26.	Azinfos-etil	2642-71-9	220-147-6	2933 99 90	2933 99 80	p(1)-p(2)	n-n	
27.	Azinfos-metil (#)	86-50-0	201-676-1	2933 99 80	2933 99 80	p(1)	n	
28.	Azociklotin (+)	41083-11-8	255-209-1	2933 99 80	2933 99 80	p(1)	n	
29.	Benfurakarb (+)	82560-54-1		2932 99 00	2932 99 00	p(1)	n	
30.	Bensultap	17606-31-4		2930 90 85	2930 90 99	p(1)-p(2)	n-n	
31.	Benzene (5)	71-43-2	200-753-7	2902 20 00	2902 20 00	i(2)	rr.n	
32.	Benzidine dhe kriperat e tij	92-87-5,	202-199-1,	2921 59 90	2921 59 90	i(1)-i(2)	rr.n-n	



	(+) Derivatet e Benzidines (+)	36341-27-2 dhe te tjera	252-984-8 dhe te tjera —			i(2)	n	
33.	Bifenthrin	82657-04-3		2916 20 00	2916 20 00	p(1)	n	
34.	Binapakril (#)	485-31-4	207-612-9	2916 19 50	2916 16 00	p(1)-p(2)	n-n	Lutemi referojuni Qarkores PIC ne www.pic.int
						i(2)	n	
35.	Bitertanol (+)	55179-31-2	259-513-5	2933 99 80	2933 99 80	p(1)	n	
36.	Butralin (+)	33629-47-9	251-607-4	2921 49 00	2921 49 00	p(1)	n	
37.	Kadmium dhe komponimet e tij	7440-43-9 dhe te tjera	231-152-8 dhe te tjera	8107 3206 49 70 dhe te tjera	8107 3206 49 70 dhe te tjera	i(1)	rr.k	
38.	Kadusafos (+)	95465-99-9	Jo i aplikueshem	2930 90 85	2930 90 99	p(1)	n	
39.	Kalciferol	50-14-6	200-014-9	2936 29 90	2936 29 00	p(1)	n	
40.	Kaptafol (#)	2425-06-1	219-363-3	2930 50 00	2930 50 00	p(1)-p(2)	n-n	Lutemi referojuni Qarkores PIC ne www.pic.int
41.	Karbaril (+)	63-25-2	200-555-0	2924 29 95	2924 29 98	p(1)-p(2)	n-n	
42.	Karbofuran (+)	1563-66-2	216-353-0	2932 99 85	2932 99 00	p(1)	n	
43.	karbon tetrakloride	56-23-5	200-262-8	2903 14 00	2903 14 00	i(2)	n	

44.	Karbosulfan (+)	55285-14-8	259-565-9	2932 99 85	2932 99 00	p(1)	n	
45.	Kartap	15263-53-3		2930 20 00	2930 20 00	p(1)-p(2)	n-n	
46.	Kinometionat	2439-01-2	219-455-3	2934 99 90	2934 99 90	p(1)-p(2)	n-n	
47.	Klorat (+)	7775-09-9 10137-74-3 7783-92-8 dhe te tjera	231-887-4 233-378-2 232-034-9	2829 11 00 2829 19 00 2843 29 00	2829 11 00 2829 19 00 2843 29 00	p(1)	n	
48.	Klordimeform (#)	6164-98-3	228-200-5	2925 21 00	2925 21 00	p(1)-p(2)	n-n	Lutemi referojuni Qarkores PIC ne www.pic.int
49.	Klorfenapir (+)	122453-73-0		2933 99 90	2933 99 80	p(1)	n	
50.	Klorfenvinfos	470-90-6	207-432-0	2919 90 90	2919 90 00	p(1)-p(2)	n-n	
51.	Klormefos	24934-91-6	246-538-1	2930 90 85	2930 90 99	p(1)-p(2)	n-n	
52.	Klorobenzilate (#)	510-15-6	208-110-2	2918 18 00	2918 18 00	p(1)-p(2)	n-n	Lutemi referojuni Qarkores PIC ne www.pic.int
53.	Kloroform	67-66-3	200-663-8	2903 13 00	2903 13 00	i(2)	n	
54.	Klortal-dimetil (+)	1861-32-1	217-464-7	2917 39 95	2917 39 95	p(1)	n	



55.	Klozolate (+)	84332-86-5	282-714-4	2934 99 90	2934 99 90	p(1)-p(2)	n-n	
56.	Kolekalciferol	67-97-0	200-673-2	2936 29 90	2936 29 00	p(1)	n	
57.	Cinidon-etil (+)	142891-20-1	Jo i aplikueshem	2925 19 95	2925 19 95	p(1)	n	
58.	Koumafuril	117-52-2	204-195-5	2932 29 85	2932 20 90	p(1)-p(2)	n-n	
